



Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë (FSDK) shpallë:

Rishpallje: Konkurs për vend pune

Titulli: Zyrtar(e) i/e Lartë

Njësia: Për Menaxhimin e Rrezikut

Raporton: Drejtorit Menaxhues

Kohëzgjatja e punësimit: Me afat të pacaktuar

Niveli: Niveli – I

Përshkrimi i përgjithshëm:

Zyrtar(e) i/e Lartë për Menaxhimin e Rrezikut është përgjegjës për identifikimin, vlerësimin, trajtimin, minimizimin, menaxhimin, monitorimin dhe raportimin e rreziqeve ndaj të cilëve FSDK-ja mund të ekspozohet gjatë veprimtarisë së saj. Pozita ka rol kyç në zhvillimin dhe zbatimin e kornizës së menaxhimit të rrezikut, duke siguruar që FSDK operon në përputhje me ligjin, politikat e brendshme dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Mbështet njësitet dhe funksionet e FSDK-së për identifikimin, vlerësimin, minimizimin, dhe raportimin e rreziqeve në FSDK;
- Krijon dhe mirëmban regjistrin e rreziqeve të identifikuara në bashkëpunim me njësitet/funksionet e tjera të FSDK-së, e mirëmban atë në baza të rregullta dhe e përditëson atë në përputhje me rrethanat;
- Kryen vlerësim nëpërmjet stres testeve mbi profilin e rrezikut të bankave anëtare të FSDK-së përmes të dhënave që i merr nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe raporton rezultatet tek Bordi Menaxhues nëpërmjet Drejtorit Menaxhues;
- Raporton në baza gjysmëvjetore mbi dinamikën e Indikatorëve kryesorë të rreziqeve duke përfshirë ato të Indikatorëve të paralajmërimit të hershëm tek Bordi Menaxhues nëpërmjet Drejtorit Menaxhues;
- Raporton në baza gjysmëvjetore për efektivitetin e masave të menaxhimit të rrezikut bazuar në veprimet e planifikuara në regjistrin e rreziqeve tek Bordi Menaxhues nëpërmjet Drejtorit Menaxhues;
- Propozon tek Drejtori Menaxhues propozime për marrjen e masave për minimizimin dhe menaxhimin e rreziqeve të identifikuara;
- Ndjek procesin e zbatimit të masave të marra për menaxhimin e rreziqeve;
- Ofron mbështetje në hartimin e Indikatorëve për monitorimin e rreziqeve për politikat e investimeve të FSDK-së, politika të tjera të brendshme në fusha të tilla si rreziqet ndaj sigurimit të depozitave, kompensimit të depozitorëve dhe operacioneve të TI-së dhe monitoron zbatimin e tyre;
- Koordinon dhe mbështet hartimin, rishikimin dhe përditësimin e Planeve të Kontigjencës dhe Planeve të Vazhdimësisë së Punës, në bashkëpunim me njësitet përkatëse;
- Paraqet tek Drejtori Menaxhues propozimet mbi deklaratën për nivelin e apetitit dhe tolerancës së rrezikut;
- Jo më pak se një herë në dy vjet analizon Politikën dhe Procedurat e Menaxhimit të Rrezikut me qëllim rishikimin e saj dhe i raporton Drejtorit Menaxhues për propozimet përkatëse për ndryshim;

- Organizon trajnime për punonjësit mbi politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut për zbatimin efektiv të kontrolleve të brendshme;
- Bashkëpunon me auditorët, rregullatorët dhe partnerët ndërkombëtarë;
- Zyrtar përgjegjës në APK lidhur me Planin e integritetit;
- Kryen detyrat në lidhje me monitorimin e bankave anëtare mbi pajtueshmërinë me rregullativën e FSDK-së mbi informimin e depozitorëve me sistemin e sigurimit të depozitave në Kosovë;
- Mbështet në aktivitetet e vetëdijësimit publik.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diplomë universitare në ekonomi, financa, bankë, menaxhment apo fusha të ngjashme (master i preferuar);
- Përvojë e dëshmuar (së paku 5 vite) në fushën e menaxhimit të Rrezikut, apo fusha të ngjashme në sektorin bankar;
- Njohuri të avancuara për kornizat e Rrezikut dhe standardet ndërkombëtare (COSO, Basel, etj.).

Njohuri, Aftësi dhe gatishmëri tjera të kërkuara:

- Të dëshmojë njohuri të mirë të gjuhës Angleze me shkrim dhe në të folur;
- Të dëshmojë njohuri njohuri të mira të aplikacioneve aktuale kompjuterike, programeve të Microsoft Office;
- Aftësi komunikuese dhe koordinuese të shkëlqyera;
- Shkathtësi të shkëlqyera analitike dhe aftësi raportimi;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në ekip, me integritet të lartë profesional;
- Gatishmëri për të avancuar njohuritë në fushat e kërkuara nga përgjegjësitë dhe detyrat;
- Qasje fleksibile ndaj detyrave të ndryshme dhe orarit të punës.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentet në vijim:

1. CV të detajuar.
2. Letrën motivuese ku theksohet interesimi për pozitën.
3. Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it; Kopje të certifikatave profesionale.
4. Dëshmitë e përvojës punës (kontrata të punësimit ose referencave të lëshuara nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës).
5. Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse.
6. Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Republikës së Kosovës.

Si të aplikoni:

- Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është **06.02.2026**.
- Mund të aplikoni përmes postës elektronike në adresën: komisioni@fsdk.org duke bashkangjitur komplet dosjen, ose t'a dorëzoni në zarf në zyret e FSDK-së (adresa: Rr. Bekim Fehmiunr.31, Kati i I-rë, Lakërishtë").
- Kandidatët e përzgjedhur për testim do të njoftohen brenda 15 ditëve kalendarike nga data e mbylljes së konkursit për ditën e testimit.
- Kandidatët e përzgjedhur për intervistë do të informohen brenda 10 ditëve kalendarike pas datës së testimit.

Aplikacionet e pa kompletuara me 6 dokumentacionet e lartpërmendura nuk do të merren parasysh.